

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " Interport Logistics " SHPK

Sot ne daten 03.10.2023 , une e nenshkruara :

Soalda Hila, e datelindjes 31.10.1988, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, pajisur me Leternjoftim nr. 033118700 dhe nr. personal I86031055F,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " **Interport Logistics** " SHPK.

#### **NENI 1**

##### **EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet " **Interport Logistics**" SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-ne .

#### **NENI 2**

##### **SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, Lagjja 1, Rruga Taulantia, Autoriteti Portual Durres, Prane Terminalit, Zyra Nr.5

Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 3**

##### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Agjenci doganore, spedicionere. Spedicion për ngarkesa brënda dhe jashtë vendit. Asistencë profesionale në fushën e spedicionit dhe shërbimit doganor. Perfaqësimi i shoqerive transportuese dhe spedicionere dhe kryerja e veprimeve doganore. Tregti, import-eksport të mallrave të të gjitha llojeve dhe ndërmjetësim tregtar. Transport mallrash të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Kalimi i mallrave nën garancinë e agjencisë doganore. Magazinë doganore. Bashkëpunim dhe kooperim me shoqëritë tregtare brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria gjithashtu mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

#### **NENI 4**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali i shoqerise " **Interport Logistics**" SHPK eshte 100.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% ,nga ortakut i vetem i saj, Soalda Hila.

#### **NENI 5**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

-Asambleja e pergjithshme.

-Administratoret.

#### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.

-Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

#### **ADMINISTRATORET**

**Administrator i shoqerise do te jete** Soalda Hila, e datelindjes 31.10.1988, lindur ne Durrës dhe banuese ne Tiranë, , pajisur me Leternjoftim nr. 033118700 dhe nr. personal I86031055F, , e cila emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripertesitje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja , me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

#### **NENI 7**

##### **Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

#### **NENI 8**

##### **Prishja e shoqërisë.**

Prishja e shoqërisë

Shoqëria prishet :

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "QKR",
- d)me vendim te gjykates,
- dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

#### **NENI 9**

##### **Likuidimi i shoqërisë.**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës

Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

**NENI 10****Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë  
Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE****SOALDA HILA**